

Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri


Metodologjia

Pse një vrojtim mbi migracionin e kthimit?!

- Emigracioni i lartë edhe gjatë 2001-2011
- Kthime relativisht të konsiderueshme gjatë tre viteve të fundit para Censusit të Popullsisë dhe Banesave, 2011
- Nevoja për më shumë informacion për migracionin e kthimit dhe ri-integrimin e migrantëve shqiptarë


Emigrimi

- Një nga faktorët kryesor të rënies së numrit të popullsisë, midis periudhës midis dy censuseve të fundit
- Metoda indirekte – 481.000 **emigrantë** 2001-2011
- Vendet kryesore destinacion:
 - Italia
 - Greqia




Të kthyerit

- 139.000 rezidentë shqiptarë që kanë jetuar ndonjëherë jashtë vendit u kthyen në Shqipëri pas 2001
- Nga të kthyerit - **2 herë më shumë meshkuj** sesa femra
- Relativisht të rinj – shpërndarja moshore për të dyja gjinitë është e ngjashme
- Arsyet: **punësimi dhe arsyet familjare**



Të kthyerit

- Numri i të kthyerve është rritur ndjeshëm pas 2008
 - kthimet kryesisht nga **Greqia**, ndjekur nga **Italia**



Vrojtimi: Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri

- Objektivat kryesore:
 - Profilizimi i migracionit të kthimit në Shqipëri, faktorët shtytës dhe tërheqës, karakteristikat e migrantëve të kthyer;
 - Mbledhja e informacionit për përvojat e migrantëve dhe perceptimet për ri-integrimin në Shqipëri;
 - Formulimi i disa rekomandimeve për aktorë të ndryshëm në lidhje me migracionin e kthimit dhe ofrimin e shërbimeve që lehtësojnë ri-integrimin e të kthyerve.

Metodologjia

- **Objekt i vrojtimit**
 - Një shtetas shqiptar **18 vjeç e lart** që ka migruar jashtë vendit dhe është kthyer në Shqipëri, vullnetarisht ose jo pas **vitet 2009**
- **Përkufizime kryesore**
 - **Të kthyer** -Çdo person që kthehet në vendin e tij/saj të origjinës, pasi ka qenë migrant ndërkombëtar (minimalisht për një vit) në një vend tjetër. Kthimi mund të jetë i përhershëm ose i përkohshëm. Ai mund të vendoset në mënyrë të pavarur nga migranti ose të detyrohet nga rrethanat e papritura.
 - **Vendi kryesor i emigracionit/destinacionit** - i referohet vendit të fundit të imigrimit ku ka jetuar i intervistuari përpara kthimit në vendin e origjinës.

Metodologjia

- **Kampionimi**

Censusi i fundit i popullsisë dhe banesave u përdor si kuadër për të ndërtuar **një kampion** përfaqësues për të gjithë vendin, madhësia e të cilit ishte rreth 2000 individë

- **Mbledhja e të dhënave**

Puna në terren u krye nga 16 shtatori - 14 tetor 2013. Vrojtimi u bazua në metodën e intervistimit ballë për ballë dhe është kryer nëpërmjet teknologjisë CAPI

Pyetësi me tre faza

- Pyetësi ndjek gjerësisht modelin e **Cassarinos**, duke u përshtatur në disa raste referuar situatës tonë specifike (kryesisht në pjesën e ri-integrimit)
 1. Situata para se të largoheshin nga vendi
 2. Eksperienca e migracionit në vendin e fundit të emigrimit
 3. Kthimi - kushtet pas kthimit

Falë këtij pyetësi u bë e mundur:

- Të kuptohej masa në të cilën eksperienca migratore po ashtu edhe konteksti social dhe institucional, kanë ndikuar në strukturën e ri-integrimit;
- Të analizohej pse dhe si kapitali human, social dhe financiar i të intervistuarve ka ndryshuar gjatë kohës;
- Të krahasoheshin faktorët e ndryshëm që kanë motivuar dhe i kanë dhënë formë etapave të migracionit

Pyetësori

Faza 1	Faza 2	Faza 3
Situata përpara largimit nga vendi i origjinës	Përvoja e migracionit në vendin kryesor të imigracionit	Kthimi në vendin e origjinës - kushtet pas kthimit
<p>Karakteristika demografike dhe sociale; Arsyet për largimin nga Shqipëria; Kushtet sociale dhe financiare përpara largimit nga Shqipëria; Përbërja familjare përpara largimit (nëse ka); Shkollimi dhe aftësitë përpara largimit; Situata e punësimit.</p>	<p>Përvoja e migracionit; Arsyet për të jetuar në vendin/vendet e imigracionit; Kohëzgjatja e përvojës së jetuar jashtë vendit; Kushtet sociale dhe financiare në vendin/vendet e imigracionit; Përbërja familjare (nëse ka); Shkollimi dhe aftësitë e fituara jashtë vendit; Situata e punësimit dhe financiare; Marrëdhëniet me institucionet vendore jashtë vendit dhe me shoqërinë pritëse; Lidhjet/kontaktet me Shqipërinë.</p>	<p>Udhëtimi i kthimit; Arsyet dhe faktorët që nxisin kthimin; Kohëzgjatja e pritshme e kthimit; Kushtet sociale dhe ekonomike pas kthimit; Përbërja familjare pas kthimit; Shkollimi dhe aftësitë e fituara pas kthimit; Statusi i punësimit dhe financiar pas kthimit; Marrëdhëniet me institucionet vendore dhe shoqërinë në Shqipëri pas kthimit; Lidhje me vendin/vendet e mëparshëm të imigracionit; Projekt pas kthimit dhe qëndrueshmëria e kthimit.</p>

Faleminderit për vëmendjen!

Majlinda Nesturi
mnesturi@instat.gov.al